

Shoqëria "ANBI" Shpk
Nipt K02715442R
Selia, Fier, Roskovec,

**VENDIM I Asamblese se Ortakeve
Te Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"ANBI" Sh.p.k.
NR 02 Datë 18. Korrik .2018**

Në Fier, sot me datën 18 .Korrik.2018, në selinë e shoqërisë, Asambleja e Ortakeve të shoqërisë "ANBI" Sh.p.k. zhvilloi mbledhjen sipas rendit të ditës në vijim:

RENDI I DITES:

- 1) Largimin nga shoqëria "ANBI" Shpk të ortakut Besmira Hazbiu , dhe dhurimin e 15.900 kuotave së zotëruar prej saj në shoqëri, të cilat përfaqësojnë 50 % të kapitalit shoqëror të shoqërisë "ANBI" Shpk, në favor të ortakut të ri Enri Hazbiu .
- 2) Pranimin në shoqëri të ortakut të ri Enri Hazbiu atesia Avni, amesia Esma , i datelindjes 10/07/1990, lindur në Roskovec dhe banues në Roskovec Fier , shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar me numër personal J00710025T .

Ortaku Besmira Hazbiu largohet nga shoqëria me vullnetin e saj të lirë dhe ka rënë dakort që këto kuota të cilat përfaqësojnë 50% të kapitalit të shoqërisë të përbërë nga kapitali i nënshkruar, të transferohen tek ortakut i ri Enri Hazbiu , nepermjet dhurimit , i cili ka shprehur vullnetin e tij për të pranuar dhurimin e këtyre kuotave duke trashëguar kështu 50% të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë

Aasambleja e Ortakeve , në respektim të statutit, Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare" të ndryshuar me Ligjin Nr. 129/2014, Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, Ligjit Nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Legjislacionin Fiskal e Tatimor,

VENDOSI

- 1) Miratimin e largimit nga shoqëria "ANBI" Shpk të ortakut Besmira Hazbiu dhe dhurimin e 15.900 kuotave të zotëruar prej saj të cilat përfaqësojnë 50 % të kapitalit shoqëror të shoqërisë "ANBI" Shpk, në favor të ortakut të ri Enri Hazbiu , i cili pas këtij transferimi do të bëhet zotëruese e 50 % të kapitalit në shoqërinë Anbi shpk .
- 2) Parnimin në shoqëri të ortakut të ri Enri Hazbiu atesia Avni, amesia Esma , i datelindjes 10/07/1990, lindur në Roskovec dhe banues në Roskovec Fier , shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar me numër personal J00710025T
- 3) Vendimi i mësipërm do të shoqërohet nga kontrata e dhurimit së kuotave sa më sipër.

Me nënshkrimin e këtij vendimi dhe kontratës së dhurimit së kuotave, ortake te shoqërisë 'Anbi' shpk bëhen :

Enri Hazbiu , zoterues i 50 kuotave , me vlere te pergjithshme 15.900.000 leke, dhe qe perfaqesone 50% te kapitalit te shoqërisë

Artur Zanaj, zoterues i 50 kuote , me vlere te pergjithshme 15.900.000 leke, dhe qe perfaqesone 50 % te kapitalit te shoqërisë. dhe administrator i shoqërisë riemerohet z. Artur Zanaj , i cili do të ushtrojë detyrat e administrimit për një periudhë 5 vjeçare sipas ligjit dhe statutit.

Ngarkohet administratori i ri i shoqërisë z. Artur Zanaj , të depozitojë këtë vendim dhe kontratën e shitjes së kuotave, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i tyre, për të reflektuar ndryshimet e mësipërme në skedën e shoqërisë sipas ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar me Ligjit Nr. 129/2014, Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, Ligjit Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", me tejkalimin e këtij afati, shoqëria detyrohet të paguajë penalitet të parashikuar nga ligji.


Vendimi i mësipërm është hartuar në gjuhën shqipe në katër ekzemplarë me vlera të njëjta juridike, dhe nënshkruhet rregullisht nga asambleja e ortakeve te shoqërisë "ANBI " Shpk .

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Artur Zanaj
AZ

Besmira Hazbiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË VLORE
NOTERE PUBLIKE FLORAXH.ZOTO
Nr. 2562 REP.
Nr. 128 KOL



KONTRATË DHURIMI E KUOTAVE TË KAPITALIT

Në shoqërinë me Përgjegjësi të kufizuar

“ANBI” SHPK

Në Fier, sot me datë 15. KORRIK . 2018 , përpara meje noteres Flora Zoto , anëtare e Dhomës së Noterisë Fier, me seli në Rugen Dervish Hekali u paraqitën personalisht,

Palët e mëposhtme :

DHURUESI :

1-Besmira Hazbiu , atesia Avni , amesia Esmë e datelindjes 03/06/1985, lindur ne Roskovec dhe banues ne Fier , shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar prej meje noteres me leternjoftim me numër personal I55603015L , ortak i shoqërisë “ANBI” Shpk, regjistruar në regjistrin tregtar të shoqërive tregtare, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 27/06/2010 me Nipt K02715442R zotërues i 15.900 kuotave te kapitalit shoqëror të shoqërisë “ANBI” Shpk, e cila përfaqëson 50 % të Kapitalit Shoqëror.

PRANUESI I DHURIMIT :

z. Enri Hazbiu, atesia Avni, amesia Esmë , i datelindjes 10/07/1990, lindur ne Roskovec dhe banues ne Roskovec Fier , shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, njohur prej meje noteres me leternjoftim me , me numër personal J00710025T .

Të cilët me vullnet të lirë e të plotë, më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate dhurimi kuotash në respektim të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “i ndryshuar, si më poshtë:

Dhuruesi Besmira Hazbiu , është njeri prej ortakeve ,zotërues i 50% te kapitalit në Shoqërinë “ANBI “ shpk, e cila është një shoqëri tregtare shqiptare e regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar të Shoqërive Tregtare, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 27/06/2000 , me Nipt K02715442R

Nepermjet vendimit numer 02 te dates 18/07/2018 , Ortaku i shoqerise “ANBI “shpk, Besmira Hazbiu ka miratuar transferimin e 15.900 kuotave qe perfaqesojne 50 % të kapitalit shoqëror qe ajo zoteron ne kete shoqeri në favor të ortakut te ri Enri Hazbiu .

Ortaku i shoqërisë "ANBI " shpk Besmira Hazbiu ka rënë dakort që ky kapital te transferohet nepermjet dhurimit dhe pranuesi i dhurimit Enri Hazbiu ka shprehur vullnetin e tij për të pranuar dhurimin e këtij kapitali .

Objekti i kontrates

Dhuruesi Besmira Hazbiu e cila është ortak , zotërues i 15.900 kuotave në shoqërinë "ANBI " Shpk **transferon nëpërmjet Dhurimit** te gjithë kapitalin e zoterur prej saj ne shoqerine ANBI shpk , me vullnet të lirë e të plotë, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", i ndryshuar, Statutin e Shoqërisë dhe vendimit të asamblese se Ortakeve të shoqërisë numer 02. date 18/07/2018 , në favor të ortakut te ri Enri Hazbiu .

Garancitë

Pala Dhuruese deklaron dhe garanton pranuesin e dhurimit se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotes që po transferohet nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Heqja dorë nga të drejtat

Dhuruesi Besmira Hazbiu deklaron nën përgjegjësinë e tij personale, se heq dorë nga nga te gjitha te drejtat qe i takojne mbi zoterimin e 50 % te kapitalit ne shoqerine Anbi „SHPK. .

Të ndryshme

Pas realizimit të këtij transferimi me nënshkrimin e kësaj kontrate, dhuruesi Besmira Hazbiu zhvishet teresisht nga zoterimi i 50 % te kapitalit te shoqerise Anbi shpk , dhe pranuesi i dhurimit Enri Hazbiu , behet pronar i ligjshem me pjesemarje 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise „Anbi „ shpk,me vlere te pergjithshme 15.900.000 leke

Pjesët përbërëse të kontratës

Pjesët përbërëse të kësaj kontrate janë: *ekstrakti i shoqërisë "ANBI shpk, fotokopjet e dokumentave identifikuese të palëve në këtë kontratë, vendimi i Asamblese se ortakeve te shoqerise .*

Kjo kontratë u hartua nga unë noterja në katër ekzemplarë me vlere të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, dhe pasi shpreh vullnetin e lirë e të plotë të palëve në këtë kontratë, nënshkruhet regullisht sipas ligjit nga palet përpara meje dhe unë noterja vërtetoj rregullshmërinë e tyre.

DHURUESI

Besmira Hazbiu

PRANUESI I DHURIMIT

Enri Hazbiu

NOTERE
FLORA XH. ZOTO

Flora Xh. Zoto